

VENDIM
Nr.60, datë 8.9.2010

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “ANSARA
KONCENSION” SHPK**

Në mbështetje të neneve 8, pika 2 germa “a”, 9 dhe 13 pika 1, germa “a”, të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, të nenit 4, pika 1, germa “a”, dhe të nenit 10, pikat 1 dhe 3 të “Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108, datë 9.9.2008, të nenit 18, pika 1, germa “a” të rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.21, datë 18.3.2009, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 8.9.2010, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Ansara Koncension” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike,

dhe konstatoi se:

Aplikimi plotëson përgjithësisht kërkesat e ERE-s, lidhur me licencimet në sektorin e energjisë elektrike të:

- formatit të aplikimit (neni 9, pika 1);
- dokumentacionit juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2);
- dokumentacionit financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3);
- dokumentacionit teknik (neni 9, pika 4).

Mungesa e dokumentacionit që ka të bëjë me paraqitjen e lejes së përdorimit të ujit për prodhimin e energjisë elektrike dhe lejes mjedisore nga organet përkatëse, janë në proces përfundimi (neni 9 pika 4.1.5, gerrat “b” dhe “c”).

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për shqyrtimin e aplikimit për licencë të shoqërisë “Ansara Koncension” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga hec “Labinot-Mal-Elbasan”.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-s
Bujar Nepravishta